

**AKT THEMELIMI
DHE STATUTI
I SHOQËRISË “ej ANNAIS e gjeta” SHPK**

Sot, më 27.09.2022, unë i nënshkruari Ernis Kullafi, shtetas shqiptar, lindur në Krujë, Shqipëri lindur më 17/08/1986, mbajtës i kartës se identitetit me numër personal I60817004R, nëpërmjet këtij akti, themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 1
Emërtimi**

Shoqëria emërtohet **“ej ANNAIS e gjeta” shpk** (në vijim referuar si “Shoqëria”).

**Neni 2
Forma Juridike**

“ej ANNAIS e gjeta” Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"*, të ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

**Neni 3
Selia**

- 3.1.** Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: *"Rr. Mehmet Brocaj vila 6, kati parë m 15, Tiranë"*.
- 3.2.** Administratori, me vendim të Ortakut të Vetëm, sipas ligjit, mund të hapë dhe/ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 4
Kohëzgjatja**

- 4.1.** Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare Biznesit.
- 4.2.** Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

ERNIS KULLAFI



Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

- 5.1.** Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si vijon:
- Mobileri
 - Design
 - Transport
 - Real estate
 - Zyre punësimi
 - Airbnb shërbim hotelerie
 - Shërbim pastrimi
- 5.2.** Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të realizohet objekti i mësipërm i veprimtarisë, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie me qira, apo hipotekor.
- 5.3.** Shoqëria, me qëllimin për të investuar në kapital, mund të ketë interesa dhe marrë pjesë në shoqëri të tjera, konsortiume etj., që kanë objekte veprimtarie të çdo lloji, të ngjashme me objektin veprimtarisë së saj.
- 5.4.** Pavarësisht sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm të lejuar nga ligji për realizimin objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 6

Kapitali

- 6.1.** Kapitali i Shoqërisë është ALL 100 (njëqind) lekë
- 6.2.** Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me një vlerë prej ALL 100 (njëqind) lekë.

Neni 7

Ortaku i Vetëm

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

Z. Ernis Kullafi, shtetas shqiptar, lindur në Krujë, Shqipëri lindur më 17/08/1986, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal I60817004R, zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 100% të kapitalit themeltar në shumën prej 100 (njëqind Leke).

ERNIS KULLAFI



Neni 8
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1** Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 8.2.** Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e 100 (njëqind) lekë, që është minimumi i vlerës së kërkuar nga ligji.

Neni 9
Transferimi i Kuotës


Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10
Vendimmarrja

- 10.1.** Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.
- 10.2.** Ortaku i Vetëm është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- i. përcaktimin politikave e biznesit të Shoqërisë;
 - ii. modifikimin, ndryshimin, plotësimin e statutit;
 - iii. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndarjen e kompetencave të tyre, si dhe shpërblimin përkatës;
 - iv. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
 - v. transferimin e kuotave;
 - vi. shpërndarjen e fitimeve;
 - vii. riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
 - viii. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky Statut.

Neni 11
Regjistri i Vendimeve

- 11.1** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet mëposhtme: e

ERNIS KULLAFI


- i. miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ii. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
- iii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- iv. vendime në lidhje me investimet;
- v. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.

11.2. Lista e mësipërme nuk është shteruese. Dhe vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin Vendimeve, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 12 Administrimi

12.1. Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë.

12.2. Administratori i parë i Shoqërisë është:

Z. Ernis Kullafi, shtetas shqiptar, lindur në Kruje, Shqipëri lindur më 17/08/1986, mbajtës i kartës se identitetit me numër personal I60817004R

12.3. Administratori do të emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.


12.4. Kompetencat specifike të secilit Administrator do të vendosen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të ndryshohen në të njëjtën mënyre.

12.5. Administratorët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm.

Neni 13 Kompetencat e Administratorit

13.1. Administratorët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin e zbatueshëm.

13.2. Kompetencat dhe detyrat e administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:

ERNIS KULLAFI


- i. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
- ii. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
- iii. kryerjen e të gjitha veprimeve lidhur me administrimin veprimtarisë së Shoqërisë; e
- iv. sigurimin e mbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare kontabël të Shoqërisë; dhe
- v. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
- vi. kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;
- vii. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në këtë Statut.

13.3. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky Statut janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.

13.4. Kompetencat e secilit Administrator mund të vendosen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të modifikohen në të njëjtën mënyrë.

13.5. Administratorët mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij tek persona të tjerë.

Neni 14 **Audituesi ligjor**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 15 **Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare**

15.1. Viti ushtrimor fillon më datë 1 te muajit janar dhe mbaron më datë 31 te muajit dhjetor të çdo viti.

15.2. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe audituesit ligjor të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

ERNIS KULLAFI


15.3. Miratimi i dokumenteve lidhur me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.

Neni 16 Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

16.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj.

16.2. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

16.3. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi "në likuidim e sipër" duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 17 Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

17.1. Ky akt bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Dispozitat ligjit 9901, datë e 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar do të zbatohet për çështjet që nuk rregullohen nga ky dokument.

17.2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

“ej ANNAIS e gjeta” shpk

ORTAKU I VETËM

ERNIS KULLAFI

ERNIS KULLAFI
